



REPUBLIKA E SERBISË
MBROJTËSI I QYTETARËVE

21-6/12
B e o g r a d



Mbrojtësi i qytetarëve

akt.nr. 4894 data 2. 3. 2012.

KUVENDI I REPUBLIKES SE SERBISE
-prof. dr Slavica Đukić-Dejanović, kryetare -

11000 BEOGRAD
rr. Trg Nikole Pašića 13

Në pajtim me nenin 107 fq. 2 Kushtetuta e Republikës së Serbisë ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 98/2006) dhe nenit 18 paragrafi 1 i Ligjit për Mbrojtësin e qytetarëve ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 79/2005 dhe 54/2007) dhe në bazë të nenit 161 të Rregullores së Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 52/2010 dhe 13/2011), i parashtroj Kuvendit Kombëtar

AMENDAMENTIN
NË
PROPOZIMIN E LIGJIT PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR
PROCEDURË JASHTËKONTESTIMORE

AMENDAMENTI

Në nenin 174b, paragrafi 1 në fund të tekstit pika zëvendësohet me një presje dhe shtohen fjalët "si dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut".

A r s y e t i m

Amendamenti i propozuar synon që në zgjidhjen e problemit me të cilat ballafaqohen qytetarët, të cilët, për arsye objektive, nuk mund të plotësojnë kërkesat për regjistrim në librin amë të lindjeve dhe kështu bëhen të "padukshëm" në sistemin ligjor të këtij vendi, të përfshihen organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me amendamentin e propozuar krijohet baza që me mbrojtjen e të drejtave "të personave të padukshëm me ligj" të merren, jo vetëm autoritetet shtetërore, por edhe shoqëria civile dhe organizatat të cilat edhe deri më tani janë angazhuar me sukses në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prandaj, në tekstin e nismës për ndryshimin e Ligjit për procedurën jashtëkontestimore nga Mbrojtësi i qytetarëve drejtuar Qeverisë së RS-së, është propozuar që "procedura për përgatitjen e dokumenteve në lidhje me faktin e lindjes të inicohet sipas detyrës zyrtare, me kërkesë të personit nga neni 174a, personit tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë juridik, organit kujdestar ose **organit gjegjësisht organizatës e dedikuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut**".

Me amendament kërkohet që neni 174b i Ligjit të hartohet ashtu siç është hartuar në Nismën e Mbrojtësit të qytetarëve drejtuar Qeverisë së Republikës së Serbisë, dhe të cilën qeveria e ka pranuar kur Kuvendit Kombëtar i ka paraqitur projekt-ligjin ku përfshihej iniciativa, përveç që nga teksti origjinal janë mënjeluar fjalët "si dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut".

Me këtë amendament, Mbrojtësi i qytetarëve propozon që Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë të pranojë zgjidhje që është në interes të drejtpërdrejtë të të drejtave të qytetarëve në identitet.

MBROJTESI I QYTETAREVE

Saša Janković

T'i dorëzohet edhe:

- Ministrisë së Drejtësisë, Ministres Snežana Malović